



Nr./Br./No. 1676 Nr. i faq./Br.str/No. p.

Data/Datum/Date 10.10.2023

PRISHTINË - PRISHTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo *Qeveria - Vlada - Government*

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin:
Specialist i Arsimit, Grupi Nr. 49

Nr. 1676/2023
Datë: 10.10.2023

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin: Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, Grupi Nr. 58 i themeluar me Vendimin Nr. 02/164, të datës 09.10.2023, e në mbështetje të nenit 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 34 paragrafi 12 i Ligjit Nr. 06/L/114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me datë 10.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

**Për shtyrje të afatit për përfundimin e procedurave të rekrutimit për pozitën e nivelit profesional
Inspektori i Tregut**

I. Shtyhet afati i përfundimit të procedurës së rekrutimit Inspektor i Tregut, i shpallur me datë: 14.07.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme/Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, Grupi Nr. 58: Specialist i Administrimit të Përgjithshëm, me Nr. Ref: RN00012073 dhe kod RPC 0005653.

II. Afati sipas pikës I të këtij Vendimi shtyhet tridhjetë (30) ditë kalendarike nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

III. Obligohet DMZP-ja të njoftoj të gjithë kandidatët të cilët kanë hyr në listën e ngushtë për shtyrjen e testit me shkrim.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Nr. 58, Specilaist i Administrimit të Përgjithshëm, për shkak që nuk ka rrethana të mundshme juridike për të vazhduar dhe deri në përfundim të procedurave dhe shqyrtimeve përkatëse administrative shtyhet afati sikur parashikohet me LPPA për përfundimin e procedurave për pozitën " Inspektor i Tregut ".

Nga kjo që u tha më lart u vendos si në Dispozitiv të këtij Vendimi.



kryesues i Komisionit të Pranimit
për Grupin Nr. 58: Specialist i i Administrimit të Përgjithshëm